VENDIM
Nr. 59, datë 31.3.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC TERFOJA" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 411/1 prot., datë 28.3.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë "HEC Terfoja" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 25, datë 14.2.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "HEC Terfoja" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/3 prot., datë 14.2.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 28.2.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Shoqëria "HEC Terfoja" sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
- Nga analizimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "HEC Terfoja" sh.p.k., rezultoi se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si më poshtë:
- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c": plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e": plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d": plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat "a", "b" dhe "c": plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "HEC Terfoja" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti